



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.1593/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Faton Bajrami, kryetar i kolegjit, Franciska Zhitija Ymeri dhe Saranda Bogaj Sheremeti, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit N.T. “Nedri Commerce” me seli në Ferizaj, kundër të paditurës Dogana e Kosovës (DK), në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti Fiskal, KF.nr.282/2023 të datës 25.10.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 08.05.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë -Departamenti Fiskal, KF.nr.282/2023 të datës 25.10.2023, **vërtetohet**.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti Fiskal, KF.nr.282/2023 të datës 25.10.2023, është aprovuar si e bazuar kërkesëpapia e paditësit N.T. “Nedri Commerce” me seli në Ferizaj, Anulohet aktvendimi nr.07.3/421/2017 i datës 03.07.2019 i Doganës së Kosovës në Prishtinë. Obligohet e paditura Doganës së Kosovës në Prishtinë, që paditësit N.T. “Nedri Commerce” me seli në Ferizaj, t’ia kthej shumën prej 3,140.80€ (tremijë e njëqind e dyzetë euro e tetëdhjetë cent) të paguar më tepër, në emër të detyrimeve doganore, për shkak të rivlerësimit të mallit të importuar përmes Deklaratës Unike Doganore me nr. R-14435/01.06.2017 dhe R-15273/09.06.2017 të proceduar në Zyrën e Brendshme Doganore Hani Elezit, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi. Ndërsa Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë e paditura, për shkak të: shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës material. Me propozim që të aprovon ankesën në tërësi si të pa bazuar në ligj. Prishet aktgjykimi , KF.nr.282/2023 të datës 25.10.2023, ta refuzon padinë dhe kërkesën e paditësit në tërësi si të pabazuar me ligj dhe të lë në fuqi vendimin e kontestuar ose t’ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore në ankesë, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të LKA-së, nenit 81.H të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), gjeti se:

- Ankesa është e pa bazuar

Nga shkresat e lëndës rezulton se me aktvendimin e kundërshtuar nr.07.3/421/2017 i datës 03.07.2019 është refuzuar si e pabazuar kërkesa e subjektit në procedurë N.T. “Nedri Commerce”-Ferizaj, për rishqyrtimin e vendimeve (DUD-ave) nr. R-14435/01.06.2017 dhe R-15273/09.06.2017 të ZD Hani Elezit.

Paditësi i pakënaqur me vendimin e të paditurës, ka ushtruar padi për konflikt administrativ, me pretendim se i njëjti është i padrejtë dhe i paligjshëm. Dhoma e Shkallës së Parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit, si dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin kërkesëpadinë e paditësit e aprovon si të bazuar, duke anuluar vendimin lartcekur të paditurës, si dhe duke obliguar të paditurën Dogana e Kosovës, në Prishtinë, që paditësit N.T. “Nedri Commerce” me seli në Ferizaj, t’ia kthej shumën prej 3,140.80€ (tremijë e njëqind e dyzetë euro e tetëdhjetë cent) të paguar më tepër, në emër të detyrimeve doganore, për shkak të rivlerësimit të mallit të importuar përmes Deklaratës Unike Doganore me nr. R-14435/01.06.2017 dhe R-15273/09.06.2017 të proceduar në Zyrën e Brendshme Doganore Hani Elezit, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi. Me arsyetim se Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhoma e Shkallës së dytë, me Aktvendimin K.DH.SH.II. nr.1141/22 të datës 04.05.2023, kanë miratuar si të bazuar ankesën e paditësit, ndërsa aktgjykimin A. nr.1786/19 të datës 19.11.2021 e kanë anuluar dhe lëndën e kanë kthyer në shkallën e parë në rigjykim me rekomandimin që dhomat e shkallës së parë të kësaj gjykate të vlerësojnë edhe njëherë transferet e datës 24.05.2017 dhe 25.05.2017 në Pro Credit Bank të cilat nuk korrespondojnë se janë të përfunduara ashtu siç parashihet në paragrafin 3 të nenit 33 të KDA-së. Gjykata nga shkresat e lëndës ka vlerësuar se me asnjë provë nuk është provuar konstatimi i të paditurës i dhënë në vendimin e kontestuar, sipas të cilit vlera e deklaruar e mallit lëndor nga paditësi, nuk është vlere reale e paguar e mallit me qëllim importi në vendin tonë në vështrim të nenit 33 të KDAK-së. Gjykata ka konsideruar se paditura do të mund ta mbështetet një konstatim të këfillë vetëm atëherë kur do të mund të siguronte dëshmi konkrete se paditësi për mallin lëndor kontestues, i ka paguar eksportuesit mbi çmimin neto të faturës të mallit, ku vlere e mallit të faturuar nga eksportuesi është paguar nga paditësi përmes transfereve ndërkombëtare dalëse nr. 390504226 të datës 24.05.2017 dhe nr. 390674815 të datës 25.05.2017 të dëshmuara me pasqyrën bankare nga Pro Credit Bank të datës 10.11.2021 dhe e cila i referohet periudhës 24.05.2017. Pra në interpretim të drejtë të dispozitave ligjore, Gjykata ka konstatuar se në rastin konkret paditësi ka paraqitur transferet ndërkombëtare dalëse nr. 390504226 të datës 24.05.2017 dhe nr. 390674815 të datës 25.05.2017 të dëshmuara me pasqyrën bankare nga Pro Credit Bank të datës 10.11.2021 dhe e cila i referohet periudhës 24.05.2017, e të cilat transfere janë të harmonizuara me faturat e mallit kontestues si në kuptim të shumës ashtu edhe të pagesës së bërë. Në këto rrethana, Gjykata ka vlerësuar se të gjitha këto dokumente rezultojnë të jenë të

harmonizuara në tërësi sa i përket vlerës së mallit të importuar nga paditësi në kuptim të nenit 33 par.1 të KDAK-së. Gjykata i ka vlerësuar deklaratimet dhe provat tjera materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës, por erdhi në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështje juridike administrative.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Dhoma e Shkallës së Parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8 i Ligjit për Procedurën Kontestimore, në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore, si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejtë ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar. Sa i përket pretendimeve ankimore të përfaqësueses së autorizuar të paditurës, se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës, këto pretendime ankimore nuk qëndrojnë, ngase aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës administrative, e as me shkelje të tjera të cilat do të ndikonin në drejtëshmërinë dhe ligjshmërinë e aktgjykimit të goditur. Meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së, dhe LPA-së. Ndërsa, sa i përket pretendimeve ankimore të paditurës, për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, këtë pretendim Dhoma e Shkallës së Dytë, e refuzon si të pa bazuar. Në rastin konkret kjo gjykatë, as në ankesë, e as në shkresat e lëndës, nuk ka gjetur asnjë provë bindëse që dëshmon konstatimin se paditësi ka deklaruar vlerë më të vogël se sa vlera reale e paguar për eksport në vendin tonë, ashtu siç e përcakton neni 33 i Kodit Doganor dhe i Akcizave të Kosovës. Në këtë rast e paditura para gjykatës është dashur që me prova bindëse të dëshmojë se ia ka paguar paditësit – eksportuesit të mallit vlerën më të vogël se sa vlera e deklaruar me DUD-at kontestues, si dhe faturat përcjellëse të mallit lëndor, gjë që nuk e ka bërë një gjë të tillë. Të paditurës i është dhënë mundësia që ti paraqes të gjitha provat dhe faktet bindëse që dëshmojnë se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar, por një gjë të tillë nuk e ka bërë, por e njëjta vetëm se ka pretenduar se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar, por pa e mbështetur pretendimin e saj në dispozitat ligjore konkrete. Dhoma e Shkallës së Dytë, e vlerëson si të drejtë dhe të ligjshëm vlerësimin e Dhomës së Shkallës së Parë me të cilën ka vlerësuar se paditësi ka paraqitur paditësi ka paraqitur transferet ndërkombëtare dalëse nr. 390504226 të datës 24.05.2017 dhe nr. 390674815 të datës 25.05.2017 të dëshmuara me pasqyrën bankare nga Pro Credit Bank të datës 10.11.2021 dhe e cila i referohet periudhës 24.05.2017, e të cilat transfere janë të harmonizuara me faturat e mallit kontestues si në kuptim të shumës ashtu edhe të pagesës së bërë, andaj Dhoma e Shkallës së Dytë konstaton se janë përmbushur kriteret ligjore për tu pranuar vlera e deklaruar sipas faturave të mallit të deklaruar me Deklaratat Unike Doganore kontestuese. Prandaj, një veprim i tillë është në përputhje me dispozitat ligjore nga ligji nr.03/L-109.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore se qëndrimi i gjykatës është i gabuar dhe jo i bazuar në dispozita ligjore lidhur me konstatimin se paditësi deklaratës doganore i ka bashkangjitur faturën, transaksionin bankar dhe se me këto prova është e mjaftueshme që të aprovohet padia dhe mallit të vlerësohet sipas metodës së parë, është konkluzion i gabuar dhe gjithashtu interpretim i gabuar i gjykatës pasi që paditësi në të gjitha fazat e zhvillimit të procedurës në kontratën e shitblerjes të lidhur me eksportuesin e mallit, nuk ka cekur mënyrën e realizimit të pagesës së mallrave kontestuese, mënyrën e kontraktimit të mallit, mbrojtjen juridike të tyre në rast kontesti, nuk ka specifikuar natyrën e mallrave kushte mbi të cilat lidhet kontrata, pra kontratat nuk mund të konsiderohet valide pasi që nuk ka të dhëna të mjaftueshme si dhe për DUD-in R-14435/01.06.2017 nuk ka prezantuar deklaratën eksportuese të shtetit eksportues, pra paditësi nuk ka paraqitur dokumentacion të harmonizuar sa i përket vlerës së mallit të importuar nga paditësi, kolegji këto pretendime nuk i aprovoj sepse me dispozitat e Kodit Doganor dhe Akcizave të Kosovës nr. 03/L-109 dhe as me dispozitat e UA nr. 11/2009 për Implementimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave nuk parashihet që kontrata dhe deklarata eksportuese janë dokumente të cilat duhet bashkangjitur deklaratës doganore për vendosje të mallit në qarkullim të lirë të mallit të importuar dhe për tu aplikuar metoda e parë e vlerësimit sipas nenit 33 të KDAK-së. Andaj, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, kjo gjykatë gjen se Dhoma e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur është bazuar në dispozitat e LPA, LKA, Ligjit nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, Kodi nr.03/L-109 Doganor dhe i Akcizave në Kosovë, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr.04/L-099.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditurës. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale në dëm të paditurës, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se të njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, andaj, ankesa e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditësit, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura, të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e të paditurës, u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhoma e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II.nr.1593/23, me datë 08.05.2024

Kryetar i kolegjit,
Faton Bajrami